



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

*Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 14.06.2022, ora 12:00

**Drejton mbledhjen:**

**Arben Pëllumbi – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Shqyrtimi dhe votimi i projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil” (*Komision përgjegjës*)

**Marrin pjesë:**

Arben Pëllumbi, Fadil Nasufi, Laert Duraj, Ilir Ndraxhi, Luljeta Bozo, Tatjana Piro, Baftjar Zeqaj, Benet Beci, Lefter Gështenja, Zef Hila, Ramadan Likaj, Rrahman Rraja, Ismet Beqiraj, Xhelal Mziu, Nusret Avdulla, Agron Duka dhe Ilir Pendavinji.

**Mungojnë:**

Helidon Bushati, Anduel Tahiraj, Flamur Hoxha dhe Fatjon Veizaj.

**Të ftuar:**

Hantin Bonati – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Kledia Ngjela – Drejtoreshë e Përgjithshme e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë

Lilika Radovicka – Drejtoreshë e Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Urban

Maksim Et’hemaj – Drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil

Edlira Kraja – Drejtoreshë Juridike e Autoritetit të Aviacionit Civil

## HAPET MBLEDHJA

**Arben Pëllumbi** – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Sot në rendin e ditës kemi një seancë për vazhdimin e diskutimeve në lidhje me projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”. Ne kemi bërë një seancë ku kemi diskutuar, kemi debatuar për projektligjin, ndërsa sot do të kalojmë në votimin në parim të tij, pastaj do të kemi diskutimin nen për nen dhe votimin e tij. Relator kemi zotin Laert Duraj.

Të ftuar janë: zoti Hantin Bonati, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, zonja Kledia Ngjela, drejtoreshë e Përgjithshme e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë, zonja Lilika Radovicka, drejtoreshë e Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Urban, zoti Maksim Ethemaj, drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil, si dhe zonjën Edlira Kraja, drejtoreshë Juridike e Autoritetit të Aviacionit Civil.

Projektligji ka kaluar në komisionet e tjera, raportet përkatëse kanë ardhur dhe ju janë vënë në dispozicion të gjitha propozimet që vijnë prej tyre. Procedojmë me votimin në parim të këtij projektligji. Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? 6 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Fillojmë diskutimin nen për nen. Secili nga ju ka përpara tabelën me ndryshimet. Do të doja që të na ndiqte relatori.

Neni 1. Në shkronjën “b” Komisioni për Çështjet Ligjore ka bërë një propozim, të hiqen fjalët “dhe legjislationin e aplikueshëm”; për teknikë legjislative duhet të mos jetë ky togfjalësh. Jeni dakord me këtë? Ka nevojë që ta lexojmë? Objekti i këtij ligji janë përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil, në vijim “autoriteti”.

Në shkronjën “b”, ku propozohet edhe ndryshimi “procedurat dhe legjislationi i aplikueshëm” hiqen. “Për refuzimin, pezullimin dhe revokimin e licencave, lejeve, autorizimeve dhe certifikatave, legjislationin e aplikueshëm në rastin e ankimimit të vendimeve të autoritetit”.

Kush është dakord me nenin 1, sipas propozimeve të bëra nga Komisioni për Çështjet Ligjore? Kundër? 6 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2 nuk ka ndryshime, është siç është propozuar në variantin fillestar. Kush është dakord me nenin 2?

Po, zoti Bonati.

**Hantën Bonati** – Kam vetëm diçka të vogël. Te titulli i kreu II, të jetë statusi përpara, organet drejtuese dhe struktura e autoritetit, se vjen në kronologji me radhitjen e neneve.

**Arben Pëllumbi** – Jemi ende te kreu I, neni 2.

Kush është dakord me nenin 2, siç është propozuar në variantin fillestar? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kreu II. “Organet drejtuese, statusi dhe struktura e autoritetit”

Zoti Bonati, kishit diçka?

**Hantën Bonati** – Te përkufizimi i kreu, statusi të ishte i pari, pastaj organet drejtuese dhe struktura e autoritetit për të qenë në kronologji edhe me nenet.

**Arben Pëllumbi** – Neni 3. Kemi një ndryshim që është propozim i Komisionit për Çështjet Ligjore: “Autoriteti është person juridik publik, jobuxhetor me seli në Tiranë, veprimtaria e të cilit është nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e ministrit që mbulon çështjet e Transportit Ajror, në vijim “ministri”. Ky është propozimi që ka bërë Komisioni për Çështjet Ligjore. Jeni dakord me këtë ndryshim? Kush është dakord me nenin 3, sipas propozimit të bërë nga Komisioni për Çështjet Ligjore? Kundër? 6 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4 “Organet drejtuese të autoritetit janë këshilli drejtues dhe drejtori ekzekutiv”. Ky është propozimi. Kush është dakord me nenin 4? Kundër? 6 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5, i cili ka lidhje me Këshillin Drejtues. Nuk ka sugjerime, është varianti origjinal. Kush është dakord me nenin 5? Kundër? 6 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6 “Kompetencat e Këshillit Drejtues”. Këtu kemi disa sugjerime nga Komisioni për Çështjet Ligjore. Shkronja “a” mbetet siç është. Ndërsa në shkronjën “b” bëhet një

ndryshim: “Propozon te ministri strukturën organizative të autoritetit, e cila miratohet me urdhër të Kryeministrit”. Jeni shprehur dakord me këtë propozim?

Në shkronjën “ç” kemi një sugjerim nga Komisioni për Çështjet Ligjore. Propozohet që fjala “nëpunësit” të hiqet nga teksti. Në fakt, e kam vënë re që në të gjithë tekstin e projektligjit duhet të hiqet fjala “nëpunësit”.

Në shkronjën “i”, po e njëjta gjë, të hiqet fjala “nëpunësit”. Ndërkohë që kërkohet të shtohet një pikë në fund, shkronja “k” me këtë përmbajtje: “Merr vendime për çështje të tjera në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi”.

**Ismet Beqiraj** – Lidhur me kompetencat e këshillit drejtues, te shkronja “c” shprehet: “Miraton metodologjinë për caktimin e masës së trajtimeve të tjera, financiare apo jofinanciare të administratës së autoritetit, duke marrë në konsideratë kushtet e tregut, nevojën e autoriteteve të tjera, që kryejnë aktivitetet rregullator dhe nevojat e institucionit”. Do të propozoja të shtohet edhe një togfjalësh: “Si dhe bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi”, sepse, kur këshilli drejtues ka kompetencën të përcaktojë masën e trajtimit dhe nuk i vendoset një kufi ligjor, atëherë është në tagrin e tij që t’u çojë masën, shpërblimin edhe 5-6 mijë euro, edhe unë të jem, do të them: “Po më dhanë 1 mijë, kaloj në stres”.

**Arben Pëllumbi** – Më duket se për këtë çështje të këshillit drejtues flasim diku tjetër, në një pikë tjetër.

**Kledia Ngjela** – Ky është një paragraf kuadër, miraton metodologjinë, pra nuk përcakton masën apo vlerën maksimale, metodologjinë në bazë të së cilës do të përcaktohen rregullat e përgjithshme të miratimit të trajtimeve financiare apo jofinanciare. Pra, metodologjinë se si do të bëhet trajtimi, jo trajtimin në vetvete.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Nuk kam mbaruar.

Jam shumë dakord me atë që tha deputeti, thjesht për shkak të teknikës legjislative në të gjithë tekstin e projektligjit jemi shprehur: “Sipas legjislacionit në fuqi”. Nëse do t’i qëndroni propozimit të deputeti, ju lutem konsiderojeni: “sipas legjislacionit në fuqi”, pra vetëm këtë togfjalësh, jo “në bazë të akteve ligjore në fuqi” për të qenë të unifikuar me të gjithë terminologjinë e ligjit.

**Arben Pëllumbi** – Po, zoti Beqiraj.

**Ismet Beqiraj** – Jo për të bërë debat, por një debat konstruktiv, unë e kuptoj metodologjinë, duhet kjo, kjo, kjo. Por thoni se nuk ka të bëjë thjesht me metodologjinë ky paragraf, por miraton metodologjinë për përcaktimin e masave. Ti përcakton edhe masën e

shpërblimit. Ramë në një emërues të përbashkët që të shtohet ai togfjalësh, nuk ka asnjë problem.

**Arben Pëllumbi** – Në shkronjën “c” me propozimin e zotit Beqiraj në fund të shtohet: “Sipas legjislacionit në fuqi”.

Po, zoti Beqiraj.

**Ismet Beqiraj** – Kam dhe diçka tjetër të shkronja “j”, ku thuhet: “Miraton shpërblimet dhe masën e shpërblimit të punës, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga ministria ” në shumë institucione të tjera paga e 13 është hequr, edhe në Albpetrol, edhe në arsim që është kryesore. Përveç pagës së lartë që ka ky institucion publik t’i japim dhe pagën e 13? Ka edhe benefite të tjera. Ne duhet t’i vendosim brenda piramidës së ligjit “Për pagat në Republikën e Shqipërisë” të gjithë entet, qofshin edhe ato të pavarura, jo me një disnivel të tillë, ku, për hir të së vërtetës, publikisht vazhdimisht dhe pagat e deputetit dhe deputetët bulizohen nga ana e trajtimit financiar. Për pagën e 13, dua të them që kjo pikë duhet të rishikohet.

**Arben Pëllumbi** – Zoti Et’hemaj.

**Maksim Et’hemaj** – Faleminderit, zoti kryetar!

Në lidhje me shpërblimin, nuk do ta quaj shpërblim, paga e 13 apo e 14, por do ta quaj shpërblim për performancën. Duhet të kemi parasysh diçka, nëse duam të bëjmë ndryshim të mirë, pozitiv, sidomos në aviacionin civil që për shkak të specifikës që ka, është ndërkombëtar. Pavarësisht se Shqipëria nuk është anëtare e vendeve të BE-së, një avion që fluturon nga Tirana në Londër fluturon në të gjitha hapësirat njëloj. Paga e 13-të nuk ka të bëjë me konceptim e pagës së 13-të, por ka të bëjë me konceptin e performancës. Ne po marrim, po krijojmë stafe, po i motivojmë me trajnime, po u japim kompetencë, por në fund fare do t’u matim edhe produktin që na japin. A na çon kjo performancë ne në një stad më të lartë të aviacionit civil? Kjo nuk ka të bëjë vetëm me aviacionin civil, por ka të bëjë me të gjitha kompanitë që kanë mundësi financiare dhe biznesi duhet t’i orientojë performancë stafit që ta lidhë me të ardhurat financiare.

**Laert Duraj** – Jo vetëm në cilësinë e relatorit, por edhe të një personi që ka një lloj eksperience në administrim, të paktë të ndërmarrjeve publike, mendoj që për shkronjën “j” jam shumë dakord siç është. Do të isha shumë i lumtur të kishin të gjithë mundësi të merrnin pagën e 13, absolutisht, të paktën aty ku ekziston mundësia, ka një lloj pavarësie financiare, pse jo edhe në këtë formë që është shprehur, pra të shpërblimit, mua më duket në rregull.

Ndërkohë, te shkronja “j” do të doja të kishte një shtesë: “Miraton pagat, si dhe nivelin e pagave të nëpunësve të autoritetit brenda kufirit minimal dhe maksimal të caktuar” e të gjitha me radhë. Të shtojë edhe diçka “si dhe shtesat dhe shpërblimet profesionale”. Kështu që do të doja që në pikën 1 të shtohet edhe kjo fjali. Pra, për të pasur një performancë më të lartë, unë gjithmonë nisem nga përvoja ime në lidhje me IT-të, që ishin shumë të rëndësishëm, por në rastin e autoritetit ma do mendja se ka pozicione specifike, të cilat, për shkak edhe të anës profesionale, certifikimeve apo përvojave të ndryshme, patjetër që duhet të motivohen në një mënyrë apo në një tjetër, kështu që propozoj këtë që sapo thashë.

**Arben Pëllumbi** – Nëse e kuptova mirë, propozimi juaj është pika “i”: “miraton pagat, si dhe nivelet e pagave të punonjësve të autoritetit, shtesat dhe shpërblimet profesionale, brenda kufirit minimal dhe maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në vartësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga ministri”. Ky është ndryshimi që propozuat.

Urdhëroni, zoti Ethemaj!

**Maksim Et’hemaj** – Faleminderit, zoti kryetar!

Ndryshimi është shumë i përshtatur me qëllimin e ndryshimit. Të vetmin rekomandim që do të bëja, është të ndahej fjala “shtesat dhe shpërblimet profesionale dhe VIP” pas Këshillit të Ministrave. Pra, Këshilli i Ministrave përcakton pagën bazë dhe pas kësaj të vijë pjesa “shtesat dhe shpërblimet profesionale”, sepse, ashtu siç është shkruar, duket sikur është më e limituar se sa është aktualisht.

**Arben Pëllumbi** – Qëllimi është i qartë, kështu që ne do të gjejmë mundësinë se si ta formulojmë këtë pjesë që të jemi korrektë edhe me teknikën legjislative.

Kush është dakord me nenin 6, sipas ndryshimeve që na kanë ardhur nga Komisioni për Çështjet Ligjore, si dhe propozimin e bërë nga relatori?

Edhe një herë, pika “k”, që Komisioni për Çështjet Ligjore propozon, merr vendime për çështjet të tjera në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi nuk ka nevojë të shtohet, sepse është.

Po e riformuloj edhe një herë: kush është dakord me nenin 6, sipas ndryshimeve që na kanë ardhur nga Komisioni për Çështjet Ligjore, me përjashtim të pikës “k”, e cila është aktualisht në nenin përkatës si germë “ë”, si dhe propozimin e bërë nga relatori në pikën “i”?

Pro? Kundër? 4 vota. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në nenin 7 “Kriteret e emërimit të kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues”.

Në pikën “b” kemi një riformulim nga Komisioni për Çështjet Ligjore. Pika “b” thotë: “Të zotërojë diplomë të nivelit “Master shkencor” apo “Master profesional” të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite”.

Propozimi është: të ketë diplomë të nivelit “Master shkencor” apo “Master profesional” sipas legjislacionit për arsimin e lartë”. Pra, të mbyllet këtu dhe të mos i ketë këto përcaktimet e tjera.

Urdhëroni, relatori!

**Laert Duraj** – Unë jam tërësisht dakord me këtë pjesë, sepse, po fute masterin profesional, i cili, në fakt, nuk është 2 vjet akademikë dhe nuk është 120 kredite, por është 90, në njëfarë mënyre, ka diçka që është kontradiktore, kështu që propozimi i Komisionit të Ligjeve është i drejtë, dhe, më vjen pak zor që s’e kam parë vetë, ngaqë kam edhe përvojë në këtë fushë.

Jam tërësisht dakord për këtë pjesë.

**Arben Pëllumbi** – Atëherë, kush është dakord me nenin 7, me ndryshimin që propozon Komisioni për Çështjet Ligjore në pikën “b”?

Pro? Kundër? 4 vota. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet neni 7.

Neni 8 është pa ndryshime. Kemi variantin origjinal.

Pro? Kundër? 4 vota. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet neni 8.

Neni 9 “Shpërblimet e këshillit drejtues”.

Këtu kemi një sugjerim nga Komisioni për Çështjet Ligjore; është teknikë legjislative. Në nenin 9 fjalët “në aktet ligjore në fuqi” zëvendësohen me fjalët “sipas legjislacionit në fuqi”.

A keni ndonjë koment? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 9, me ndryshimin që propozon Komisioni për Çështjet Ligjore?

Pro? Kundër? 4 vota. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet neni 9.

Neni 10 “Lirimi nga detyra i kryetarit ose anëtarit të këshillit drejtues” Edhe këtu kemi një propozim nga Komisioni për Çështjet Ligjore, por, para se të shkojmë të pika 4, unë kam një pyetje.

Në pikën 1, germa “c”, kur mungon pa arsye për më shumë se 3 mbledhje radhazi. Çfarë shpjegimi keni?

**Kledia Ngjela** – Ideja është që anëtarët e këshillit drejtues të mos marrin pjesë qoftë në mbledhjet *online*, të cilat zhvillohen rëndom tani, ashtu edhe me prezencë fizike. Mund të ndodhë që në tri mbledhje rresht të mos paraqitet dhe të mos ketë dhënë argument, ose të mos ketë njoftuar për mosprezencën e tij për shkaqe të arsyeshme. Kjo është arsyeja pse.

**Arben Pëllumbi** – Pra, ju mendoni se mosparaqitja në tri mbledhje radhazi interpretohet si një qëndrim në raport me detyrën.

**Kledia Ngjela** – Ekzakt. Është pengesë, për sa kohë që ndër 5 veta, mungesa e njërit nuk bën dot vendimmarrjen.

**Arben Pëllumbi** – Në fakt, do ta diskutojmë edhe të pika më poshtë këtë, se edhe aty kam diçka për të qenë më i qartë.

Atëherë, Komisioni për Çështjet Ligjore propozon që në nenin 10, pika 4, në fund të fjalisë, pas fjalëve “anëtarëve të këtij këshilli” të shtohen fjalët “për një mandat 4-vjeçar”.

Pra, ideja e propozimit të këtij komisioni është që anëtari i ri që zgjidhet, fiton mandatin e tij, nuk vazhdon mandatin e atij që sapo e ndërpreu. Pra, në çdo rast që do të keni zgjedhje të anëtarëve të këshillit drejtues, mandati është 4-vjeçar, pavarësisht faktit nëse ky mandat është në mes të rrugës apo është një mandat i plotë. Ky është sugjerimi.

Urdhëroni!

**Kledia Ngjela** – Për të konfirmuar atë që sapo thatë, nga Komisioni i Ligjeve është shtuar një dispozitë kalimtare, e cila përcakton që anëtarët, të cilët aktualisht janë në ushtrim të detyrës së tyre, vazhdojmë të mbajnë detyrën deri në momentin e zgjedhjes së anëtarëve të rinj.

**Arben Pëllumbi** – Pra, jeni dakord me këtë ndryshim.

Atëherë, hedhim në votim nenin 10.

Kush është dakord me nenin 10, me ndryshimin që propozon Komisioni për Çështjet Ligjore në pikën 4?

Pro? Kundër? 4 vota. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet neni 10.

Neni 11 “Mbledhjet e këshillit drejtues”.



Komisioni për Çështjet Ligjore ka bërë disa propozime.

Në pikën 1, pas fjalëve “ekzekutiv të autoritetit” shtohen fjalët “si dhe me kërkesë të ministrit.” Jeni dakord me këtë propozim? Dakord.

Në pikën 3 kërkohet një riformulim me këtë përmbajtje: “Mbledhja e këshillit drejtues zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën 3 anëtarë. Vendimet e këshillit merren me shumicë të thjeshtë. Në votim nuk lejohet abstenimi”. Unë këtu kam diçka për të qenë më i qartë.

Ju thoni që këshilli drejtues ka 5 anëtarë, 2+2+1 dhe pastaj janë 3 anëtarë, të cilët duhet të marrin pjesë. Po në rast se në mbledhjen e këshillit drejtues mungojnë të dy anëtarët që janë të një profesioni dhe çështja që shqyrtohet është e fushës së tyre?

Urdhëroni, zoti Et’hemaj!

**Maksim Et’hemaj** – Në fakt, në qoftë se i shikoni përgjegjësitë e këshillit mbikëqyrës, më tepër lidhen me anën administrative dhe financiare të Autoritetit të Aviacionit Civil, që do të thotë se pjesën funksionale, teknikalitetin ia ka lënë autoritetit, vetë drejtorit, kështu që, nëse dy veta do të jenë nga legjislacioni, do të adoptohet agenda për mbledhjen tjetër.

Kjo pjesa teknike që ka impakt të menjëhershëm, nuk ka problem, ndërsa pjesa ligjore dhe financiare, që janë më të buta në impakt, menaxhohen në këtë formë.

**Arben Pëllumbi** – Atëherë, kush është dakord me nenin 11, me ndryshimet që propozon Komisioni për Çështjet Ligjore në pikën 1 dhe në pikën 3?

Pro? Kundër? 4 vota. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet neni 11.

Kalojmë te neni 12 “Transparenca në veprimtarinë e autoritetit”.

Këtu nuk kemi sugjerime; është teksti origjinal.

Pro? Kundër? 4 vota. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet neni 12.

Neni 13 “Drejtori ekzekutiv”

Edhe këtu nuk kemi propozime.

Pro? Kundër? 4 vota. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet neni 13.

Neni 14 “Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit ekzekutiv”

Edhe këtu nuk kemi propozime.

Pro? Kundër? 4 vota. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet neni 14.

Neni 15 “Kriteret për emërimin e drejtorit ekzekutiv”

Këtu kemi një propozim nga Komisioni për Çështjet Ligjore: në nenin 15 shkronja “b” riformulohet me këtë përmbajtje: “Të ketë diplomë të nivelit “Master shkencor” apo “Master profesional”, sipas legjislacionit për arsimin e lartë”.

Është e njëjta logjikë që përmendëm edhe më lart.

Kush është dakord me nenin 15, me ndryshimin që propozon Komisioni për Çështjet Ligjore?

Pro? Kundër? 4 vota. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet neni 15.

Neni 16 “Lirimi nga detyra i drejtorit ekzekutiv

Këtu kemi një propozim nga Komisioni për Çështjet Ligjore për një pikë shtesë. Pas shkronjës “e” shtohet shkronja e re “f” me këtë përmbajtje: “Për shkak të performancës jo të kënaqshme gjatë drejtimit të autoriteti”.

Urdhëroni, zoti Duraj!

**Laert Duraj** – Për mendimin tim, është pak evazive kjo pjesë, sepse pastaj do të donim të kishim edhe se cilat janë kriteret për një performancë të pakënaqshme, gjë që do ta komplikonte më shumë.

Unë besoj se pika “c” në vetvete e përfshin edhe pikën “f”, kur thuhet se mund të largohet për shkak të paaftësisë profesionale apo neglizhencës, e cila shkakton dëme. Te dëmi mund të fusësh edhe dëmin e performancës, kështu që unë nuk e gjykoj shumë të nevojshme këtë shtesë.

**Arben Pëllumbi** – Në fakt, edhe unë mendoj si ju që, kur flasim për performancën jo të kënaqshme, është shumë evazive, ndërkohë që duhet të vëmë edhe si përcaktim disa kriterë shumë të forta se ç’do të thotë performancë, kur i ke plotësuar, kur nuk i ke plotësuar.

Unë jam dakord me relatorin që ne të mos e marrim parasysht këtë sugjerim dhe ta lëmë siç është.

Kush është dakord me nenin 16, sipas tekstit origjinal?

Pro? Kundër? 4 vota. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet neni 16.

Kalojmë te kreu III: “Organizimi dhe funksionimi i Autoritetit të Aviacionit Civil”.

Neni 17: “Organizimi dhe detyrat”.

Edhe këtu kemi disa ndërhyrje, disa propozime të bëra nga Komisioni për Çështjet Ligjore. E thamë që në fillim se në pikat 3 dhe 4, fjalën “nëpunës” do ta zëvendësojmë me

fjalën “punonjësit”. Në pikën 4, fjalët: “kontrollit të së kaluarës” zëvendësohen me fjalët “kontrollit sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar”. Njëkohësisht, në pikën 4, Komisioni i Sigurisë na ka bërë një sugjerim, që thotë: “Nëpunësit e autoritetit që mbajnë pozicione të lidhura me funksione specifike dhe që kanë akses në zonat me siguri të kufizuar i nënshtrohen kontrollit të figurës si dhe pajisen me certifikatë sigurie sipas legjislacionit në fuqi.”

Këtë e sugjeron Komisioni i Sigurisë.

Unë besoj se kjo pikë këtu ka një lloj rëndësie të caktuar në punën dhe aktivitetin e përditshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil. Kësisoj, do të donim ta sqaronim saktë se ku kemi nevojë për certifikatë sigurie, sepse nuk besoj se të gjithë punonjësit e Autoritetit të Aviacionit Civil kanë nevojë për certifikatë sigurie, duke pasur parasysh sa e vështirë është marrja e asaj certifikate, që të mos krijohet ideja se atë certifikatë mund ta marrë kushdo.

Po, zoti Et’hemaj!

**Maksim Et’hemaj** – Zoti kryetar, ju falënderoj shumë për këtë ndërhyrje. Në fakt, këtu ka pasur gjithmonë vështirësi për ta kuptuar. Në Autoritetin e Aviacionit Civil ka dy kategori punonjësish: njëra kategori punonjësish ka akses në informacionin e klasifikuar, në kompjuterë e në çdo gjë. Pra, janë gjashtë vetë, bashkë me mua shtatë, për shkak të NATO-s, që kanë informacion dhe që janë subjekt i DSIK-së.

**Arben Pëllumbi** – Pra, ju sot i keni këta?

**Maksim Et’hemaj** – Po, i kemi këta, i kemi të ngritur.

**Arben Pëllumbi** – Pra e kanë sot DSIK-në?

**Maksim Et’hemaj** – E kanë DSIK-në, sepse nuk funksionojnë dot pa këtë, nuk punojnë dot.

**Arben Pëllumbi** – Në rregull!

**Maksim Et’hemaj** – Ndërkohë, është edhe kategoria tjetër e atyre që kryejnë aktivitet rutinë, inspektues në zonat me lëvizje të kufizuara, që po t’u bashkëngjisim edhe 870 vetë staf, që ka aeroporti në këtë zonë, i bie të shkojnë 1000 vetë për DSIK. Kësisoj, unë do të propozoja ta ndanim në një paragraf ekstra, për të veçuar atë pjesë që ka akses në informacion të klasifikuar, që duhet të jetë pjesë e DSIK-së, dhe pjesa tjetër të vetë vetëm *background check*, siç është aktualisht sot. Nëse ju jeni dakord, unë kam bërë një draftim të paragrafit.

**Arben Pëllumbi** – Ky është propozimi i vetëm që na vjen nga Komisioni i Sigurisë, ndaj duhet ta kuptojmë edhe esencën e këtij propozimi. Pastaj varet nga ne se deri ku e

marrim parasysht. Ideja është se ju keni një grup punonjësish, të cilët realisht kanë informacione të sigurisë kombëtare, një grup punonjësish që hyjnë në zona me lëvizje të kufizuar, por krahas tyre ka edhe punonjës të institucioneve të tjera, të cilët nuk janë të pajisur, nuk e kanë detyrimin për t'u pajisur me këtë certifikatë. Pra, keni dy kategori punonjësish. Si e keni menduar formulimin?

**Maksim Et'hemaj** – Pika 4 është: “Nëpunësit e autoritetit...”

**Arben Pëllumbi** – Një minutë, ju lutem, para se të filloni!

Në lidhje me pikën 4, me sugjerimin e Komisionit të Çështjeve Ligjore, besoj se ne jemi dakord se fjalët “kontrollit të së kaluarës” duhet t'i ndryshojmë dhe të themi: “legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar”. Ne nuk mund ta vënë në ligj “kontrollit të së kaluarës”.

**Maksim Et'hemaj** – Paragrafi 4 i nenit 17 thotë: “Punonjësit e autoritetit, që mbajnë pozicione të lidhura me funksione specifike dhe që kanë akses në zona me siguri të kufizuar, i nënshtrohen kontrollit të së kaluarës.” Kjo ngelet siç është. Shtohet pika 5: “Punonjësit e autoritetit që administrojnë informacion që klasifikohet në ligjin “Për informacionin e klasifikuar”, i nënshtrohen rregullave të këtij ligji.” Kësisoj, ndajmë edhe pjesën e DSIK-së. Pika 5 adreson nevojën për pajisjen me DSIK. Ata që nuk kanë akses, vazhdojnë me *background check*.

**Arben Pëllumbi** – Pra, ju kërkoni shtimin e një pike 5, ku bëni dallimin midis punonjësve, pra të atyre që kanë akses në informacionin e klasifikuar sipas ligjit përkatës, që t'i nënshtrohen rregullave të këtij ligji.

Po, zoti Duraj!

**Laert Duraj** – Në fakt, po ta vërejmë me kujdes, ajo që thotë Komisioni i Ligjeve dhe Komisioni i Sigurisë është e njëjta gjë. Këtë *background check* ose kontrollin e së kaluarës, që është një nocion normal, e heqin që të dyja. Pra, edhe ministria, edhe Komisioni i Ligjeve thonë: “Kontrolli sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar”, që edhe në këtë rast është DSIK. Edhe Komisioni i Ligjeve këtë thotë. Edhe Komisioni i Sigurisë thotë të njëjtën gjë. Tani që e shikojmë me kujdes, ne kemi dy komisione, të cilat kërkojnë të njëjtën gjë. Edhe ligjet këtë kërkojnë: DSIK. Ajo që duhet saktësuar pastaj, gjë për të cilën ata ta lënë hapësirën, është niveli i sigurisë, është se ti mund ta kesh tepër sekret, mund ta kesh dhe të kufizuar, por edhe ata kanë shumë nivele të ndryshme, nëse je familjar me DSIK-në për shkak të kësaj.

Unë mendoj se në këtë rast, zoti kryetar, të dyja komisionet kërkojnë të njëjtën gjë, ndaj nuk mund të mos i marrim në konsideratë.

**Arben Pëllumbi** – Dëgjo, duhet të kemi parasysh një gjë: Komisioni i Ligjeve na ndryshon çështjen e kontrollit të së kaluarës, duke e futur te DSIK-ja.

**Laert Duraj** – Te DSIK-ja.

**Arben Pëllumbi** – Zoti Et'hemaj, ju lutem, sepse pikërisht këtu kemi një moskuptueshmëri të gjësë. Ne duhet të kuptojmë se çfarë keni parasysh ju si propozues, kur thoni: “kontrollin e së kaluarës”. Pra, ka të bëjë me çështje të sigurisë së lartë apo ka të bëjë me çështje të figurës personale. Çfarë nënkuptoni me këtë “të kaluarës”, që ne të gjejmë terminologjinë e duhur, pasi kështu nuk e lëmë dot. Duke gjetur terminologjinë e duhur, kënaqim propozimin që na vjen nga Komisioni i Çështjeve Ligjore dhe diskutojmë në lidhje me propozimin për DSIK-në, që na vjen nga Komisioni i Sigurisë. Komisioni i Ligjeve pikërisht kontrollin e së kaluarës e koncepton si një kontroll të DSIK-së.

**Maksim Et'hemaj** – Zoti kryetar, kjo moskuptueshmëri ka ndodhur që në ditën zero. Si funksionon sot? Çdo person, i cili do të punësohet në aeroport ose në Albkontroll ose në kompani ajrore, që aktivitetin e punës së vet e ka brenda rrethimit të aeroportit, pra në zona me lëvizje të kufizuar, nuk mund të fillojë punë për sa kohë që nuk është shprehur policia, Shërbimi Informativ Kombëtar dhe së fundi SHIU, që po mundohemi ta fusim, në lidhje me *background*-in e vet si person. Do të thotë: a është kriminel? A ka qenë i dënuar për akte terroriste? A është vjedhës?

Vetëm ata njerëz që marrin një konfirmim pozitiv nga këto institucione, autorizohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil që të fillojnë punën në aeroport. Në qoftë se ne do të shkonim vetëm me DSIK, pra ta interpretonim ashtu siç e kanë interpretuar ligjet dhe siguria, do të na ndodhte një kolaps total. Pse? Të gjithë punonjësit e aeroportit, për aq kohë sa Autoriteti i Aviacionit Civil ka DSIK, do të shkonin në DSIK. Nëse aeroporti kërkon të punësojë 120 vetë, për shkak të volumit të punës, do t'i duhej të priste 4-5 muaj DSIK-në, për pastërtinë e figurës.

**Arben Pëllumbi** – Pra, këtu bëjmë fjalë për kontrollin e figurës, ndërsa në propozimin që sjell Komisioni i Sigurisë bëjmë fjalë për informacionin e klasifikuar. Kemi dy gjëra të ndryshme. Kontrollin e figurës duhet ta kenë të gjithë punonjësit e Autoritetit të Aviacionit Civil, të cilët kryejnë funksione.

Atëherë, a jemi dakord ta bëjmë: “U nënshtrohen kontrollit të figurës”?

**Laert Duraj** – Ekziston si term juridik ky? A ekziston në ligj “kontroll figure”, sepse me sa di unë nuk ekziston. Pra, në qoftë se unë kam parasysh një gjë, si drejtues, do të them që Laerti do t’i nënshtrohet kontrollit të figurës, atëherë përcaktohet qartë se çfarë nënkupton: kujt do t’i drejtohesh, çfarë autoriteti, çfarë kërkon, çfarë bën? Nëse kjo është gjë evazive, nuk mund ta shkruash “kontroll figure: si diçka që ne e shpikim sipas rastit.

**Arben Pëllumbi** – Zoti Et’hemaj, stafi i komisionit më sugjeron në mënyrë të drejtë që kërkesa që i bëni ju apo që një autoritet tjetër u bën organeve shtetërore në lidhje me informacione, duhet të bazohet diku, duhet të bazohet në një ligj. Nuk besoj se ju kërkoni informacion për një punonjës tuaj, dhe SHISHI-i apo SHIU ju jep informacion përnjëherësh, meqë jeni drejtori i Autoritetit.

**Maksim Et’hemaj** – Jo, jo.

**Arben Pëllumbi** – Pra, duhet të mbështetet diku.

**Maksim Et’hemaj** – Është aneksi 17 i ICAO-s, i cili u kërkon shteteve anëtare, në këtë rast Shqipërisë, që të krijojë komitetin e të gjitha palëve që merren me aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë. Domethënë, sipas standardeve të ICAO-s, është aneksi 17, por nuk e di si është reflektuar kjo në piramidën tonë ligjore. Referencën e kemi të qartë: është aneksi 17 i ICAO-s.

Edhe në VKM, që është programi kombëtar për sigurinë, edhe në Kodin Ajror, përdoret po ajo terminologji që ne kemi përdorur këtu.

**Arben Pëllumbi** – Po, ju lutem!

**Kledia Ngjela** – Pra, ku është baza e gjithë kontrollit të së kaluarës? Është te Kodi Ajror. Kodi Ajror e ka të përcaktuar në një dispozitë të vetën: është neni 121, i cili përcakton se çfarë është kontrolli i së kaluarës. A mund ta citoj?

**Arben Pëllumbi** – Po, po, patjetër.

**Kledia Ngjela** – Atëherë, kontrolli i së kaluarës së personelit të sigurisë: “Personeli i aviacionit, që ka akses në zonat me siguri të kufizuar ose që punojnë në pozicione të lidhura me sigurinë, i nënshtrohet kontrollit të së kaluarës për një periudhë jo më të shkurtër se pesë vjet. Kontrolli përsëritet në intervale të rregullta, të cilat nuk duhet të tejkalojnë periudhën prej pesë vjetësh. Kontrolli i së kaluarës kryhet me kërkesë të Autoritetit, nga ana e ministrisë që mbulon Çështjet e Rendit Publik.”

Pra, Kodi Ajror ka të shprehur në mënyrë të detajuar një lloj procedure. Kontrolli kryhet me kërkesë të AAC-së, nga ministria që mbulon Çështjet e Rendit Publik.

**Arben Pëllumbi** – Po, urdhëro!

**Illir Pendavinji** – Meqenëse kjo pikë ka goxha debate në lidhje me mënyrën se si do të formulohet e qysh e tek, më shumë nga ana e teknikës legislative dhe jothelbësore, mendoj që ta tejkalojmë këtë pikë, të vazhdojmë me pikat e tjera. Ndërkohë juristët, edhe i aviacionit, edhe i ministrisë, por edhe juristja e komisionit, të vijmë me një formulim, i cili të jetë i pranueshëm nga të gjithë, që në fund ta kalojmë. Kështu mendoj unë. Të na vijmë me propozim konkret, që të mos vazhdojmë të debatojmë jo kështu e jo ashtu.

**Arben Pëllumbi** – Ne ndodhemi para një momenti, ku kemi të shkruar: i nënshtrohen kontrollit të së kaluarës. Këtu jemi në diskutimin e një terminologjie, që faktikisht është i përcaktuar kështu në Kodin Ajror, edhe si procedurë, se çfarë do të thotë. Pra, është i sqaruar në Kodin Ajror. Ndërkohë kemi një propozim nga propozuesi, nga drejtori, në lidhje me mënyrën se si do t'i klasifikojmë personat që duhet të pajisen me certifikatë sigurie. Pra, kemi dy nivele të ndryshme: nivelin e parë, që është për shumicën e punonjësve, të cilët hyjnë në zonat me trafik të kufizuar, me lëvizje të kufizuar, por kemi edhe një nivel tjetër punonjësish, të cilët kanë të bëjnë me informacionin e klasifikuar, ndaj duhet të marrin DSIK-në, që edhe sot e kemi këtë gjë.

Megjithatë unë jam dakord, e nëse edhe ju jeni dakord, nenin 17 e lëmë për ta kaluar në fund.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Atëherë, sugjerimi që më vjen nga Shërbimet e Kuvendit, është që në fund të pikës 4, siç është shkruar këtu, t'i nënshtrohen kontrollit të së kaluarës, sipas referimeve në Kodin Ajror. Gjithë interpretimin e “kontrollit të së kaluarës” e kemi tek Kodi Ajror, si shprehet, kush i drejtohet, si i drejtohet, si i japin përgjigje, si s'i japin përgjigje.

Ndërkohë, duhet të hedhim në votë propozimin që bëtë ju, drejtor, në lidhje me shtesën, për pikën 5, e cila ka të bëjë me DSIK-në. Po të jetë e mundur na e formuloni edhe një herë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Atëherë kush është dakord me nenin 17, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, në pikën 3, me fjalën “punonjësit”, që thamë, me pikën 4, sikurse e sugjeruam këtu, duke shtuar togfjalëshin “sipas Kodit Ajror” dhe me shtesën në pikën 5, sipas propozimit që u bë nga zoti Ethemaj. Pro? Kundër? 2 kundër. Abstenime?

Miratohet.

Kalojmë te neni 18 “Të ardhurat e Autoritetit”. Edhe këtu kemi dy propozime në nenin 13 pikën 3 fjalët “dispozitat ligjore në fuqi” zëvendësohen me fjalët “me legjislacionin

në fuqi”, pra hiqet fjala dispozita dhe vihet legjislacion në fuqi. Në pikën 4 pas fjalëve “aviacionit civil”, shtohen fjalët “si edhe shpenzimeve të tjera të nevojshme”, pra Komisioni për Çështjet Ligjore ju sugjeron të vini edhe një togfjalësh, i cili mund të marrë parasysht shpenzimet e tjera, të cilat nuk janë renditur. Pra, të keni një hapësirë për një gjë, që nesër të mos detyrohem të ndërhyjmë në ligj për një shpenzim që sot mund të mos jetë i parashikuar, por nesër mund t’ju vijë.

Kush është dakord me nenin 18 sipas propozimeve që bën Komisioni i Ligjeve në pikat 3 dhe 4? Kundër? 2 Abstenime? Nuk ka

Miratohet.

Kalojmë te neni 19. Buxheti. Pro? Kundër? 2 kundër. Abstenime?

Miratohet.

Kalojmë te neni 20. Ka të bëjë me kontabilitetin. Nuk ka sugjerime. Pro? Kundër? 2 kundër. Abstenime?

Miratohet.

Neni 21. Raportimi dhe kontrolli.

Po zoti Beqiraj.

**Ismet Beqiraj** - Duke parë në tërësi këtë projektligj shumë të rëndësishëm mbase është një harresë, por nuk besoj se Autoriteti i Aviacionit Civil, si çdo strukturë tjetër dhe institucion publik ose jo publik të jetë i imunizuar të mos preket nga fenomeni i shpërdorimit të detyrës dhe korrupsioni. Unë nuk shikoj asnjë nen ose paragraf ku të parashikohet auditimi zyrtar vjetor lidhur me përdorimin e të ardhurave financiare që realizohen, ndaj do të propozoja më konkretisht që pas nenit 21 të shtohet një nen, ose edhe te neni 21 ku është raportimi dhe kontrolli të shtohet një pikë me këtë përmbajtje: “Autoriteti i nënshtrohet auditimit financiar vjetor mbi përdorimin e të ardhurave sipas legjislacionit në fuqi”. Dje u bë konferenca kombëtare antikorrupsion por ne nuk përdorim asnjë element kontrollues, por i lëmë në habitatin e tyre lidhur me përdorimin e fondeve për ato drejtime që ka ky institucion i rëndësishëm.

**Maksim Et’hemaj**- Ajo që unë do të them është se Autoriteti i Aviacionit Civil monitorohet më shumë nga të gjitha në Shqipëri.

**Arben Pëllumbi** – Si bëhet sot?

**Maksim Et’hemaj**- Ne kemi KLSH-në, që bën audit si zakonisht, kemi kontrollin nga Ministria e Transporti, dhe përpos këtyre kemi dy audite ndërkombëtare, një nga Komisioni European, që vjen çdo dy vjet, si edhe nga Organizata Botërore e Aviacionit Civil



që e kemi tani në korrik dhe që bëhet një herë në 4 vjet. Pra, Aviacioni është i harmonizuar dhe me standarde.

**Arben Pëllumbi** – Po, zoti Beqiraj.

**Ismet Beqiraj** – Ne mund të themi çfarë të duam, por edhe OSHEE-ja, edhe Albpetroli kanë pasuri kombëtare, administrojnë pasuri kombëtare, energjinë, jetën e ekonomisë, gjakun e ekonomisë edhe kanë kontrolle, ndërsa këtu mbi bazën e Kodit të Aviacionit është ky projektligj “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”, por Aviacioni Civil nuk ka një instrument kontrolli.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Plotësisht jam dakord, ato janë, por mos e lër këtë ligj të zhveshur nga instrumenti i goditjes së korrupsionit në Shqipëri. Edhe ku në një institucion ku pagat janë luks, shpenzimet, trajtimet, shpërblimet.

**Arben Pëllumbi** – Zoti Beqiraj, do të doja në vëmendjen tuaj nenin 21, ku flitet për kontrollin dhe raportin dhe ku është e detajuar e gjithë pjesa si kontrollohet. Brenda muajit prill të vitit pasardhës Autoriteti i paraqet ministrit një raport vjetor për veprimtarinë e tij përfshirë të gjitha vendimet e marra nga Këshilli Drejtues. Pasqyrat financiare vjetore një raport për realizimin e të ardhurave dhe të shpenzimeve një raport mbi vendimet e marra për licencat e dhëna. Pra, sigurisht që i paraqet këto në bazë të ligjit për auditimet, si të gjitha entet buxhetore kontrollohet.

**Ismet Beqiraj** – Çdo institucion i pavarur në këtë komision dhe komisione të tjera që kontrollohen nga Kuvendi e japin llogari.

**Arben Pëllumbi** – Nuk kontrollohet nga Kuvendi ky autoritet.

**Ismet Beqiraj** - Por çuarja e raportit në ministri nuk është kontroll, audit.

**Arben Pëllumbi**- Është audit si për të gjitha institucionet buxhetore. Ky nuk bën përjashtim.

**Ismet Beqiraj** – A doni ta hiqni këtë si instrument, e hiqni me mekanizmin e votës dakord, por unë them se është një institucion shumë i rëndësishëm

**Arben Pëllumbi** – Nuk ka asnjë lloj mekanizmi, ju doni të shtoni një gjë, e cila sipas meje nuk është e nevojshme.

**Ismet Beqiraj** – Autoriteti i nënshtrohet auditimit financiar vjetor sipas legjislacionit në fuqi. Se bën tenderë ky autoritet sipas procedurave për shërbimet që ka. Po këto tenderë a nuk duhet të kontrollohen?

**Arben Pëllumbi**- Po sigurisht që kontrollohen.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

**Ismet Beqiraj** - Është tjetër kur i çon raport ministrit dhe është tjetër institucioni i kontrollit. Ky është mendimi im.

**Arben Pëllumbi** - Do të doja vëmendjen tuaj që qëllimi i këtij komisioni nuk është të përjashtojë nga kontrolli këtë institucion, por ne po diskutojmë të mos shtojmë një gjë që është e qartë dhe e shprehur edhe në ligje të tjera të cilët rregullojnë veprimtarinë e autoriteteve jobuxhetore.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Zoti Pendavinji .

**Ilir Pendavinji** – Në fakt, kjo është në bazë të legjislacionit apo jo? Pra, a duhet futur këtu kjo pikë e kontrollit me auditin apo jo? Mbase specialistët e komisionit mund të na japin ndonjë vlerësim. Pra, a ekziston ndonjë ligj që mund të futet kjo që të ushtrohet kontrolli?

Unë jam dakord me kryetarin që nuk mund të futet, por të na e thonë specialistët.

**Arben Pëllumbi** - Fakti që e vëmë ose jo nuk ndryshon mënyrën si kontrollohet ky institucion, por nëse mund ta vëmë ne nuk na prish asnjë punë.

Pra, në rast se shtojmë këtë fjali, propozim të deputetit Beqiraj, a e kemi të mbështetur në legjislacionin mbi të cilin kontrollohen entet varësisë që ju keni? A mbështet diku apo e kemi si nyje të huaj këtu.

**Kledia Ngjela** – Sapo e konfirmova me drejtorin, raporti i fundit i KLSH-së është i vitit 2021. Kështu që monitorohet dhe auditohet rregullisht për veprimtarinë financiare, për performancë.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Unë jam juriste dhe di të them se nuk ka asnjë vlerë të shtuar nëse e fusni. Nëse dëshironi hidheni në votim , por vlerë të shtuar nuk ka, për ekonomi ligjore nuk ka pse të futet.

**Arben Pëllumbi**- Zoti Beqiraj, ju lutem, është e drejta juaj të propozoni ashti siç e gjykoni, por nuk është e drejta juaj të keni të vërtetën absolute, prandaj, ju lutem, më i kujdesshëm në deklaratimet që bëni. Këtu askush nuk do të lërë askënd jashtë kontrollit. Të gjithë këtë qëllim kemi, por po flasim për teknikë legjislative, sepse ne jemi Kuvendi i Shqipërisë dhe nuk mund të bëjmë përplasje ligjesh. Staf i komisionit nuk më jep dakordësinë për këtë gjë. Ministria nuk e jep dakordësinë për këtë gjë, kështu që të nderuar kolegë kemi një propozim të zotit Beqiraj për një ndryshim në nenin 21.

Kush është dakord me propozimin e zotit Beqiraj për një shtesë në nenin 21? 3 pro. Kundër? Abstenime? Nuk ka.

Nuk miratohet.

Hedhim në votim nenin 21 sipas tekstit origjinal të paraqitur nga Këshilli i Ministrave. Kush është dakord? Kundër? Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu IV, “Kodi etik, profesionalizmi dhe konfidencialiteti”.

Neni 22, “Kodi etik dhe profesionalizmi.” Edhe këtu kemi nga Komisioni i Ligjeve një propozim që duhet të heqim fjalën “nëpunësit” dhe duhet të shtojmë drejtorin ekzekutiv, pra “Anëtarët e Këshillit Drejtues, Drejtori Ekzekutiv dhe nëpunësit e tjerë të Autoritetit gjatë ushtrimit të veprimtarisë zbatojnë Kodin e Etikës dhe standardet profesionale të miratuara nga Këshilli”. Ky është formulimi. Kush është dakord? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 23 “Konfidencialiteti”. Edhe këtu kemi disa propozime. Pika 3 është po njësoj si kjo që sapo diskutuam. Hiqet fjala “nëpunësit” dhe shtohet “Drejtori Ekzekutiv dhe punonjësit e tjerë janë të detyruar t’i ruajnë dhe të mos i shpërndajnë të dhënat konfidenciale”. Pika 4 dhe 5 po njësoj si në pikat e tjera.

Shtohet një pikë 6, “Detyrimi për konfidencialitetin dhe mospërhapjen e të dhënave shtrihet për punonjësit e Autoritetit, anëtarët e Këshillit Drejtues për një periudhë 2-vjeçare pas mbarimit të ushtrimit të detyrës”. Kush është dakord me propozimet e bëra nga Komisioni i Ligjeve në pikën 3, 4 ,5 dhe shtesën në pikën 6? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Kalojmë te neni 24, “Marrja e masave administrative ndaj subjekteve të treta”.

A keni propozime? Kush është dakord me nenin 24 sipas tekstit origjinal? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Kalojmë te neni 25, “Ankimi ndaj vendimeve të Autoritetit”. Edhe këtu Komisioni i Ligjeve ka bërë disa sugjerime. Në pikën 1 në fund të pikës 1, ankuesi mund t’i drejtohet gjykatës...

Ju lutem, përfaqësuesit e ministrisë, më ndiqni!

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut sugjeron që në fund të pikës 1 “ankuesi mund t’i drejtohet gjykatës” të zëvendësohet me “sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Administrative”.

Në pikën 3, fjala “afatet” të zëvendësohet me “procedurat”.

Pra, “për trajtimin e ankesave zbatohen procedurat e Kodit të Procedurave Administrative” dhe jo “afatet”.

Gjithashtu, në pikën 4, ju thoni “Ankimimi në rrugë gjyqësore nuk e pengon ekzekutimin e vendimit të komisionit” sugjerimi është “përveç kur gjykata vendos ndryshe”, pra kur ka një masë sigurie.

Kush është dakord me nenin 25, sipas propozimeve që janë bërë nga Komisioni i Ligjeve për pikat 1, 3 dhe 4? Kundër?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Kemi diçka që na paska shpëtuar, mirë që e kapën shërbimet. Në pikën 4, të cilën sapo e diskutuam, thuhet: ankimimi në rrugë gjyqësore nuk e pengon ekzekutimin e vendimit të komisionit. Për cilin komision bëhet fjalë këtu?

**Kledia Ngjela** – Kryetar, duhet të ngelet Autoritetit, sepse komisioni nuk ka përkufizim dhe duhet të ketë ngelur nga drafti i vjetër.

**Arben Pëllumbi** – Kjo ka të bëjë me mënyrën se si shqyrtohen ankimimet, shqyrtohen nga vetë ministri, shqyrtohen nga një komision që ngre ministri.

**Kledia Ngjela** – Pas pikës 4 thuhet: “Për trajtimin e ankesave zbatohen procedurat e Kodit të Procedurave Administrative”, kështu që referencën duhet t’ia bëni kapitullit përkatës të Kodit të Procedurave Administrative për trajtimin e ankesave.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Jo, nuk e thashë.

**Ilirian Pendavinji** – Ka një logjikë, pasi edhe në krye të nenit 25 është ankimi ndaj vendimeve të Autoritetit. Pika 4 detyrimisht i referohet Autoritetit. “Ankimi në rrugë gjyqësore nuk e pengon ekzekutimin e vendimit të Autoritetit, përveç kur vendos ndryshe”.

**Arben Pëllumbi** - “Ankimi në rrugë gjyqësore nuk e pengon ekzekutimin e vendimit të Autoritetit, përveç kur vendos ndryshe”.

**Ilirian Pendavinji** – Pra, aty duhet të ketë një lapsus.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Laert Duraj** – Për mendimin tim shtesa në pikën 4 nuk ka kuptim. Gjykata do të vendosë dhe Autoriteti do ta kthejë atë në punë në qoftë se flitet për pushim nga puna...

**Arben Pëllumbi** – Jo, është fjala për marrjen e masës së sigurisë. Gjykata merr masë sigurie pa e shqyrtuar akoma çështjen dhe thotë, kjo të mos ndodhë, sepse nuk është fjala vetëm për pushim nga puna, por mund të jetë edhe për çështje të tjera.

**Laert Duraj** – Kjo nënkupton që ai do ta hedhë në gjyq edhe për masën e sigurisë dhe për çdo gjë tjetër.

**Arben Pëllumbi** – Ka diçka, këtu kemi drejtorin Ekzekutiv që merr një vendim, më pas ky vendim i shkon ministrit. Në gjykatë hidhet drejtori apo ministri?

Urdhëroni, zoti Et'hemaj.

**Maksim Et'hemaj** – Në mënyrë që ta kuptoni, ky kontekst nuk ka të bëjë fare me pushimin nga puna. Funksionet e Autoritetit janë 5.

E para, Autoriteti i Aviacionit Civil certifikon në momentin e futjes në operim të operatorëve të rinj përkundrejt standardit.

**Arben Pëllumbi** – Këtu jemi të qartë ne, se kjo është rrjedhojë e nenit 24, ndaj subjekteve të treta.

**Maksim Et'hemaj** – Një nga funksionet që ka Aviacioni Civil jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë botën, është që një vendim i marrë nga Autoriteti mund të ankimohet nga ministri, por në gjyq përsëri Autoriteti hidhet, sepse është i vetmi ent që ka të drejtë të pezullojë ankimet.

**Arben Pëllumbi** – Atëherë “ekzekutimin e vendimit të Autoritetit”, me shtesën përkatëse të komisionit.

Kush është dakord me nenin 25, sipas ndryshimeve që ka bërë Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si dhe ndryshimit nga “komision” në “autoritet”? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 26 “Përrjashtimet”.

Edhe këtu kemi një sugjerim nga Komisioni i Ligjeve. “Autoriteti ka të drejtë të bëjë përjashtime nga zbatimi i rregullave në fuqi”, fjala “veçanërisht” sugjeron Komisioni i Ligjeve të hiqet. “Në rastet kur parashikohen në Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë, të cilat lejojnë përjashtimet me kusht që, pas një vlerësimi të arrihet në konkluzionin që mospërputhshmëria dhe masat e marra (këtu vazhdon sugjerimi), mitigueuse do të garantojnë nivel të pranueshëm sigurie”.

Do të zëvendësohet “do të garantojnë nivel të pranueshëm sigurie” dhe në fund të dispozitës shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje: “Këshilli drejtues propozon te ministri udhëzimin për procedurën e aplikimit të përjashtimeve”.

Edhe këtu kemi një sugjerim nga Komisioni për Çështjet Ligjore. Autoriteti ka të drejtë të bëjë përjashtime nga zbatimi i rregullave në fuqi”. Për fjalën “veçanërisht”

komisioni sugjeron të hiqet. “Në rastet kur parashikohen në Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë, të cilat lejojnë përjashtimet me kusht që pas një vlerësimi të arrihet në konkluzionin që mospërputhshmëria dhe masat e marra (këtu vazhdon sugjerimi) mitiguese do të garantojnë nivel të pranueshëm sigurie”. Zëvendësohet me fjalët: “Do të garantojnë nivel të pranueshëm sigurie”. Në fund të dispozitës shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje: “Këshilli drejtues propozon te ministri udhëzimin për procedurën e aplikimit të përjashtimeve”. Kemi një propozim nga Komisioni për Çështjet Ligjore; fjala “mitiguese” është hequr fare dhe: “masat e marra do të garantojnë nivel të pranueshëm sigurie”. Unë dua të kuptoj, sepse ju nuk keni për qëllim ta hiqni fare, “mitiguese”... Keni një qëllim, një kuptim, masa zbutëse. Ju prish punë, nëse e heqim fare, sikurse propozon Komisioni për Çështjet Ligjore? Nëse do ta lëmë, duhet ta bëjmë zbutëse. Komisioni për Çështjet Ligjore thotë të hiqet fare.

Po, zoti Ethemaj.

**Maksim Ethemaj** – Ka dy elemente që dua ta adresoj. Nuk e di ekzakt përkufizimin e fjalës “zbutëse”, por di të them se situata, që kaluam prej COVID-it, i detyroi të gjitha shtetet, duke përfshirë edhe Shqipërinë të pezullojnë ligjin që ka qenë në fuqi, që do të thotë se një pilot që të fluturojë, duhet një herë në vit të bëjë një fluturim emergjence, të bëjë kursin e anglishtes. 2 vjet nga COVID-i për shkak se nuk kishte mundësi, pilotit i binte të mos fluturonte sot. Atëherë, Komisioni Europian dhe shtetet respektive thanë “Dakord, kjo pezullohet”. Pra, këto përjashtime kanë ndodhur dhe do të ndodhin gjithmonë. E para, është shqetësimi që kam unë. Nuk e di se cili është konteksti i fjalës zbutëse.

Për sa i përket pjesës ligjore, që ligji i referohet vetëm Kodit Ajror, unë do të doja të shtoja edhe vendimin e Këshillit të Ministrave dhe urdhrat e ministrit. Pse?

**Arben Pëllumbi** – Ku e kemi këtë? “Në rastet kur parashikohen në Kodin Ajror...”

**Maksim Et’hemaj** – “...vendimet e Këshillit të Ministrave dhe urdhrat e ministrit”. Pse? Sepse legjislacioni i Aviacionit Civil në Shqipëri transpozohet në tri trupa: parlamenti, presidenti, kur është Kodi, vendimet e Këshillit të Ministrave, si dhe urdhrat e ministrit.

**Arben Pëllumbi** – Këtu bëhet fjalë për përjashtimet. Ju keni përjashtime në të tria këto?

**Maksim Et’hemaj** – Po, se çdo rregullim vjen me përjashtimet e veta. Nëse do të flasim nesër për drone, AAC-ja ka të drejtë që të marrë masa përjashtimore në raste specifike për drone. Nëse vjen një rregullore për balonat, pra çdo rregullore vjen paketë, çfarë duhet

bërë dhe çfarë përjashtimesh duhen. Prandaj këto njësi, që sigurojnë bazën ligjore, duhet të reflektohen në ligj.

**Arben Pëllumbi** – Atëherë, Komisioni për Çështjet ligjore ka bërë dy propozime: heqjen e fjalës “mitiguese” dhe shtimin e fjalisë “Këshilli drejtues propozon të ministri udhëzimin për procedurën e aplikimit të përjashtimeve”. Gjykoj që kolegët tanë të Komisioni për Çështjet Ligjore e kanë parë më në themel përputhshmërinë e këtyre përjashtimeve, në raport si me Kodin Ajror, si me ligjet e tjera, me vendimet apo rregulloret, të cilat ju zbatoni. Unë mendoj që ta lëmë kështu siç është propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore. Të mos bëjmë ndryshime të tjera që prekin thelbin e këtij neni. Duke hequr fjalën “mitiguese”, në rast se doni ta zëvendësoni me fjalën “zbutëse”... Janë propozime të bëra dje këto prandaj.

Po, zoti Et'hemaj.

**Maksim Et'hemaj** – Dakord, mund ta lëmë propozimin e Komisionit të Ligjeve, vetëm se jo këshilli drejtues i propozon ministrit, por drejtori ekzekutiv i propozon ministrit. Pse? Do të shikoni kompetencat. Këshilli drejtues nuk ka asnjë kompetencë teknike, i ka administrative dhe financiare. Pezullimi ose kufizimi i çështjeve teknike... Pra, do të ketë një lloj mospërputhje.

**Arben Pëllumbi** – Jeni dakord që ta heqim fare fjalën “mitiguese”?

Zoti Bonati.

**Hantin Bonati** – Zoti kryetar, duke iu referuar nenit 26, nuk ishte pjesë e diskutimeve. Tani po e shikoj këtë problem që ka, referohet vetëm Kodi Ajror. Për të siguruar konsistencën me të gjitha nivelet e bazës ligjore që ne aplikojmë, do të doja të shtohen edhe vendimet e Këshillit të Ministrave dhe urdhrin e ministrit.

**Arben Pëllumbi** – Ju lutem!

Pak vëmendje!

Në Kodin Ajror kemi thënë që të gjitha përjashtimet do të përcaktohen me këtë ligj që nuk i kemi praktikisht përjashtimet. Ne nuk mund të shtojmë gjëra, të cilat janë thënë. Kodi Ajror e thotë që ky ligj duhet t'i bëjë përjashtimet. Ne këtu nuk i kemi përjashtimet. Prandaj “Drejtori ekzekutiv i propozon ministrit udhëzimet dhe procedurën e aplikimit të përjashtimeve”, do të thotë që ministri do të bëjë një shtesë për përcaktimin e përjashtimeve, këtë e thotë Kodi Ajror. Këtë po e shtojmë edhe ne këtu, meqenëse nuk është parashikuar. Kush është dakord me nenin 26 “Përjashtimet”, me heqjen e fjalës “mitiguese” dhe me

shtesën jo “këshilli drejtues, por drejtori ekzekutiv propozon te ministri udhëzimin për procedurën e aplikimit të përjashtimeve”. Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 27. Edhe këtu Komisioni për Çështjet Ligjore ka bërë një sugjerim që fjalët “aktet nënligjore” të zëvendësohen me fjalët “legjislacioni në fuqi”. Kush është dakord me nenin 27, sipas propozimit të Komisionit për Çështjet Ligjore? Dakord. Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 28 “Inspektorët e Autoritetit të Aviacionit Civil”

Kemi një dispozitë kalimtare.

Neni 28 kalon siç është, pa ndryshime, sipas tekstit origjinal. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Shtojmë një nen të ri që është neni 28/1, i cili do të bëhet neni 29, kur t’i rirëndisim që ka të bëjë me dispozitat kalimtare.

Propozimi i Komisionit për Çështjet Ligjore: “Anëtarët e zgjedhur të këshillit drejtues dhe drejtori ekzekutiv do të vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj dhe drejtorit të ri”. Ideja e periudhës së kalimit nga një status në një tjetër, të krijojë një nivel vazhdimësie të punës. Ky është qëllimi i këtij propozimi.

Kam një sugjerim që vjen nga shërbimet e komisionit për qëllimin për të cilin është vendosur kjo dispozitë kalimtare. Kjo dispozitë kalimtare ka qëllimin që anëtarët e zgjedhur të mund të mbrohen, derisa të mbarojnë mandatin, sepse me të drejtë më thonë që anëtari zgjidhet nesër, me t’u zgjedhur ti duhet të ikësh dhe vjen anëtari i ri. Ndoshta duhet jo deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj, por deri në përfundimin e mandatit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Kjo është dispozita kalimtare, sepse ndërron statusi i institucionit.

**Maksim Et’hemaj** – Jam shumë dakord dhe shumë faleminderit që e adresuat, sepse dje fillova të flisja me stafin për punën e tranzicionit dhe gjenim disa hapësira që nuk dinim si t’i menaxhonim. Duke pasur këtë shtesë, do më lejojë që ta menaxhoj tranzicionin.

**Arben Pëllumbi** – “Anëtarët e zgjedhur të këshillit drejtues dhe drejtori ekzekutiv”, po për stafin?

**Maksim Ethemaj** – Stafi, pak a shumë, është i rregulluar; DAP-i ka një procedurë një mujore që duhet të bëjë njoftimet, ajo që ne kishim problemin ishte marrëdhënia midis



meje dhe bordit, që do të thotë, siç e mendojmë ne do të ketë dy faza tranzicioni, faza e parë e tranzicionit është ndryshimi nga DAP-i në Kod, dalja nga DAP-i. Faza e dytë është miratimi dhe implementimi i strukturës. Për këtë të dytën duhet patjetër që të kishte prezencë, vazhdimësi bordi, prandaj unë e gjej shumë korrekte, shumë të dobishme.

**Arben Pëllumbi** – Dëshironi të qëndrojnë siç është apo deri në përfundim të mandatit?

**Maksim Et'hemaj** – Siç është, jemi shumë dakord.

**Arben Pëllumbi** – “Qëndrojnë në detyrë deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj dhe drejtorit”.

Po, zoti Duraj.

**Laert Duraj** – Për ndonjë rast të caktuar, fjala “zgjedhje”, pasi për arsye të ndryshme ai mund të komandojë një drejtor.

**Arben Pëllumbi** – Anëtarët e bordit zgjidhen, nuk komandohen.

**Laert Duraj** – Jo, jo të drejtorit të ri. Çfarë do të bëhet në rast, për shembull, se ka shumë të tilla që 3 muaj komandojnë dikë nga brenda.

**Arben Pëllumbi** – Është vetëm për fazën tranzitore.

**Laert Duraj** – Vetëm për ta sqaruar, sepse vota ime është totalisht pro.

**Arben Pëllumbi** – Kush është dakord me shtesën, këtu emërtohet si neni 28/1, por që në renditjen finale, do të jetë neni 29, të propozuar nga Komisioni për Çështjet Ligjore? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 29, i cili pastaj do të bëhet neni 30, ka të bëjë me shfuqizimet. Këtu nuk ka ndryshime, por kam unë një sugjerim, në fund të pikës 2, në fund të saj: “ Deri në daljen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji”, ky ligj nuk ka akte nënligjore, prandaj duhet të themi në përputhje me Kodin Ajror, pasi ai i ka aktet nënligjore. Jeni dakord me këtë riformulim?

**Maksim Et'hemaj** –Në fakt, te “Përjashtimi” doli që kishte një akt nënligjor, që ne do të përgatisim procedurën për ministrin, në rast të përjashtimeve.

**Arben Pëllumbi** – Kush është dakord me nenin 20, me ndryshimin që në fjalinë e fundit fjalët “në zbatim të këtij ligji” të zëvendësohen me fjalët “në përputhje me Kodin Ajror”? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 30 që do të bëhet neni 31. “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord në tërësi me projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit kolegë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**